

Subjekti :

Mbreti Lir është mbreti i Anglisë. Ai vendos të lere fronin e tij dhe t'ia ndajë me tre vajzave të tij, Gonerilit, Reganit dhe Kordelias. Ai i vendos ato para një prove ku do të shihet se cila nga vajzat do ta donte më shumë. Dy vajzat e mëdha nisin ta manipulojnë me fjalë, ndërsa Kordelja, vajza e vogël thotë se ajo e do babain e saj ashtu siç do femijet. Prandaj ai nuk i jep asaj nga tokat e veta, por e mallkon dhe e debon atë nga shtëpia. Nderkohe Kordelja shkon në Francë pasi mbreti i Francës është në dashuri me të. Me pas Liri e kupton se ç'gabim të rëndë kishte bërë pasi dy vajzat e debonon nga shtëpia dhe e lene në shi.

Nderkohe Konti i Glosterit ka gjithashtu probleme familjare. Djali i tij i madh, Edmundi, është i adaptuar. Ai nuk e pranon dot këtë dhe thur një intrigë sikur djali tjetër, Edgari do të vrasë babanë e tyre. Ndaj Glosteri e debon Edgarin dhe mban prapë vetes Edmundin. Kur Glosteri merr vesh që Lirin e kanë braktisur të bijat, e ndihmon atë. Regan dhe i shoqi i saj, e masakrojnë për këtë, dhe ai përfundon serishtë tek Edgari, ku shkon dhe Liri.

Një ushtri franceze nisët kundër Anglisë, e kryesuar nga Kordelja. Edmundi lidhet me dy motrat, dhe Albani, i shoqi i Gonerilit është shumë i shqetësuar rreth cështjes së Lirit, dhe për pasoje atë e vrasin. Nderkohe ushtria e Kordelias mundet dhe ajo dhe i ati mbahen peng. Nga ana tjetër ushtria angleze e Edmundit dhe motrave thyhet nga ajo e Edgarit. Glosteri tenton të vrasë veten, Edgari vret Edmundin, Gonerili vret motrën e saj për shkak të xhelozisë ndaj Edmundit dhe me pas kryen vetëvrasje, Glosteri vdes, Kordelja ekzekutohet dhe Liri vdes i thyer në zemer me trupin e saj ndër duar.

Personazhet:

Mbreti Lir - ka një karakter të dyfishtë e kontradiktor ku spikasin: despotizmi mizor me humanizmin e thellë, mendja cinike me atë plot kureshtje, dyshimi me pastertinë shpirtërore. Ai është një karakter që është formuar në ndikimin e raporteve të caktuara shoqërore. Edhe në moshe të mëdha, mbreti ka një krenari të tepruar, e vetëm me dinakeri mund t'ia fitosh zemrën. Kjo ka ndikuar keq e në edukimin e vajzave, dhe vetë Shekspiri thotë kështu. Edhe ato janë impulsive e i binden mbretit sa për sy e faqe, dhe kur u cenohet interesi bëjnë veprime ekstreme. Mbreti Lir vetëm kur mbetet jashtë kupton të verteten. Ai peshon një goditje të tmerrshme, saqë cmendet. Gjate zhvillimit të ngjarjeve ndryshon dhe mendimi i lexuesit për mbretin. Në fillim mbreti duket sikur i intereson më shumë aparenca se e verteta. Kordelja është vajza e tij e preferuar në fillim, dhe ai ndoshta e di që ajo e do më shumë, por nuk mund ta pranojë përgjigjen e saj indiferente. Me vone ai mëson nga gabimet e tij.

Kordelja - Karakteristikat e saj janë bukuri fizike e shpirtërore, ndershmëria, përkujdesja, dashuria etj. Ajo kontraston me karakteret e dy motrave. Ajo është personifikimi i virtytit, dhe nga ana tjetër një viktime e pafajshme e padrejtesive të botes.

Edmundi - është antagonisti i tragjedi. Megjithatë karakteri i tij është kompleks, pasi ai nuk vepron vetëm për interesa të tipit dedhira për pushtet, ambicja për sa më shumë, por sepse nuk mund të lejojë që shoqëria ta shohe si një bastard, siç e cilesoi dhe vetë baba i tij. Ai është shumë i ftohtë, porsë dhe shoqëria ka trajtuar atë, dhe vetëm në fund të tragjedisë shfaq një shenjë dobësie, kur sheh që Gonerili dhe Regani kishin vdekur për të.

Regan dhe Gonerili - janë personazhe negative. Në fillim ato duken të zgjuara, aq të zgjuara sa t'ia hedhin babait të tyre. Me pas ato tregohen të pashpirta dhe shumë ambicioze, të pangopura. Nuk kanë meshirë as kur perzënë babain e tyre dhe as kur verbojnë Glosterin. Në fund ato duan të kenaqen me Edmundin, por e keqja i kthehet mrapst duke i vrarë ato të dyja nga duart e njëra tjetres.

Temat :

Drejtesia

Autoriteti kundër kaosit - Liri s'është vetëm një baba, por edhe një mbret. Ai ia le trashegim fronin e tij vajzave, por nga ana tjetër kjo qeverisje i sjell kaos Anglisë.

Pajtimi - Edhe pse Liri e debon Kordelja, ajo vazhdoi ta dojë babain e saj dhe madje ta mbrojë atë. Edhe Liri i cili u tregua aq i ashpër me të, u lidh me shumë se me çdo njeri tjetër.

Motivet :

Cmenduria - Nga vuajtjet dhe tronditjet e mëdha, Liri cmendet dhe kjo cmenduri e shoqëron tërë tragjedinë. Personazhit të tij tragjik i bashkangjitet dhe personazhi komik i Lolos. Në pamjen e tij qesharake fshihet një dituri e urtësi dhe një zemer e madhe. Ai mishëron urtesinë popullore dhe e sheh jetën me sy të mprehtë dhe e di të verteten.

Tradhetia - fillimisht me femijet dhe babait, dhe vëllait me villain. Në marrëdhënien e Kordelias dhe

te atit forcohet ideja qe zemra e tradhetise eshte mospasja e nje gjykimi te drejte.

Simbolet

Shiu dhe shtrengata e madhe - simbol i krimit me te tmerrshem : uzurpimi i pushtetit dhe mosmirenjohja ndaj prindit. Ky krim i dyfishte ka prishur gjithe ekuilibrat natyrore mbi te cilet ngrihet jeta shoqerore dhe ajo individuale. Gjendja shpirterore e mbretit te shperfillur jepet pikerisht me kete shtrangate. Ajo mund te jete gjithashtu simbol i natyres qe i ben thirrje mbretit te shohe te vertetat, simbolizon drejtesine hyjonore qe eshte e thyer nga veprimet e njerezve, por edhe gjendjen ne te cilen Liri po le vendin e tij.

Verbimi - verbimi fizik i Glosterit eshte gjithashtu metaforik. Si ai si Liri kane te dy femije te ndershem dhe te pandershem , dhe ata jane te verbuar per sa kohe nuk shohin te verteten, por mbajne anen e te keqinjve. Ato jane te verbuar nga fjalet, dhe nuk mund ta shohin te verteten .

Mesazhet :

Ajo percjell ide humaniste. Liri nis te ndieje dhimbje per te varfrit dhe urrerjte e zemerim te thelle kunder krimineleve, hipokrizive dhe sistemit shoqeror. Fataliteti i pashmangshem e heronjve lidhet me denimin e tyre per te ikur nga bota e se keqes qe u solli aq shume vuajtje sa qene gjalle. Kjo tragjedi eshte kunder erresires se despotizmit te kishte pushtuar Europen ne Rilindje, dhe kjo shfaqet me kundershkrimin e hapur ndaj mbretit te Kordelias dhe Kentit. Ne fund ka shprese dhe kjo jepet me fjalet "Ju miq te dashur, te dy tok sundoni, Dhe rregullojeni shtetin e percare."